



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PML.nr.23/2025

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përberë nga gjyqtarët Agim Maliqi, kryetar, Mejreme Memaj e Afrim Shala, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale të dënuarve Leutrim Haziraj, nga fshati Ll., komuna e F., dhe Meriton Bajrami, nga S., rruga “E. L.”, për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë në vazhdimësi, parashikuar me nenin 327 par.2 nënpar.2.6 e 2.7 lidhur me nenin 31 e 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), i dënuari Leutrim Haziraj edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesat e mbrojtësve të dënuarve për mbrojtje të ligjshmërisë, avokatëve Qëndrim Rama e Liman Tahiraj, paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj, P. nr. 96/2023 datë 6 mars 2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me 20 shkurt 2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat e mbrojtësve të dënuarve Leutrim Haziraj e Meriton Bajrami për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitura kundër aktgjykimit formës së prerë të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj, P. nr. 96/2023 datë 6 mars 2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj, P. nr. 96/2023 datë 6 mars 2024, të pandehurit Leutrim Haziraj e Blerim Hejza janë shpall fajtor për shkak se si bashkekzekutor kanë kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë në vazhdimësi, parashikuar kuar me nenin 327 par.2 nënpar.2.6 e 2.7 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-së, kurse Meriton Bajrami për veprën penale vjedhje e e rëndë në bashkëkryerje, parashikuar me nenin 327 par.2 nënpar.2.6 e 2.7 lidhur me nenin 31 të KPRK. Janë gjykuar i pandehuri Leutrim Haziraj me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e katër (4) muaj, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 8.07.2015 deri me 7.10.2015 dhe dënim unik me gjobë në shumë prej 700€, të cilën është obliguar që ta paguajë në afat prej 15 ditës pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, i pandehuri Blerim Fejza me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e dy (2) muajve, kurse i pandehuri Meriton Bajrami me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, në të cilat ju është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 8.07.2015 deri me 7.10.2015. Me të njëjtin aktgjykim ndaj të pandehurve Leutrim Haziraj e Blerim Fejza konform dispozitës së nenit 362 par.1 nënpar.1.1 të KPP është refuzuar akuza për veprën penale vjedhje, nga neni 252 par.1 pika 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për shkak se prokurori është terhequr dorë nga akuza.

Në procedurën ankimore sipas ankesave të mbrojtëseve të të pandehurve aktgjykimi i lartcekur është vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin PA1.nr.829/2024 datë 29 tetor 2024.

Kundër aktgjykimeve të lartcekura kanë paraqitur kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë:

-mbrojtësi i të dënuarit Leotrim Haziraj, avokati Qendrim Rama, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë që do të siguronte integritetin e procedurës penale (kështu theksohet në kërkesë);

-mbrojtësi i dënuarit Meriton Bajrami, avokati Liman Tahiraj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që kërkesa të aprovohet aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që ndaj të dënuarit të shqiptohet dënim me kushtë.

Prokurori i Shtetit me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr. 11/2025 datë 23 janar 2025 dhe KMLP.II.nr. 11/2025 datë 3 shkurt 2025, ka propozuar që kërkesat të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoj pretendimet në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesat nuk janë të bazuara.

Mbrojtësi i të dënuarit Meriton Bajrami edhe pse e kundërshton aktgjykimet për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk konkretizon se cila dispozitë është shkelur por pretendon se gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka marrë në kundërshtim me nenin 69 par.3 nënpar.3.5, 3.6 e 3.7 të KPRK. Sipas mbrojtësit në praninë e rrethanave lehtësuese si pranimi i fajësisë, koha e gjatë e kaluar që nga kryerja e veprës penale, mosha e të dënuarit në kohën e kryerjes së veprës penale, dëmin i vogël i shkaktuar, faktin se i dënuari ia ka kthyer sendet të dëmtuarit, i njëjti tani vijon studimet në dy fakultete dhe është afër diplomimit edhe me një dënim të kushtëzuar do të mund të arrihej qëllimi i dënimit, kurse dënimi me burgim do të ndikojë në keqësimin e gjendje së tij dhe do të ketë pasoja të pariparueshme.

Kurse, mbrojtësi i të dënuarit Leotrim Haziraj pretendon se në rastin konkret kemi shkelje të dispozitave të procedurës penale pasi që të gjitha provat në këtë çështje janë nxjerrë para marrjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve. Sipas dispozitës së nenit 102 par.1 të KPP hetimi fillohet me aktvendim të prokurorit të shtetit. Aktvendimi përcakton personon kundër të cilit do të kryhet hetimi, kurse gjykata e shkallës së parë lidhur me vendosjen e kësaj çështje ka marrë për bazë pjesën me të madhe të provave që janë marrë para fillimit të hetimeve.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të lartcekura kjo gjykatë vlerëson se ato janë të pabazuara për këto arsye:

Vlen të theksohet se mbrojtësi i të dënuarit edhe pse kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e ka ushtruar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga përmbajtja e kërkesës del se e kundërshton vetëm vendimin mbi dënimin, për çka pretendimet në këtë drejtim nuk qenë objekt shqyrtimit. Sipas dispozitës së nenit 432 të KPP ndaj vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet në rast të shkeljes së ligjit penal, në rast të shkeljes esenciale të

dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 i këtij kodi ose në rast të shkeljeve tjera të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Pra, bazuar në këtë dispozitë kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të vendimit për dënim.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate edhe pretendimet e mbrojtësit të dënuarit Leutrim Haziraj nuk janë të bazuara. Sipas dispozitës së nenit 436 të KPP me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon, por nuk mund të supozojë se çka ka dashur të thotë parashtruesi i kërkesës. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës del se i dënuari Leutrim e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar, me të cilin pranim është pajtuar edhe mbrojtësi i cili tani ka ushtruar kërkesë, prandaj për këtë gjykatë nuk është e qartë se në çka konsistojnë pretendimet e mbrojtësit tani, aq me tepër kur kihet parasysh fakti se dispozitave ligjore policia sipas urdhrit të prokurorit mund të ndërmerri veprime hetimore, siç ka vepruar edhe në rastin konkret.

Nga arsyet e lartcekura kjo Gjykatë konform dispozitës së nenit 437 të KPP vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
PML.nr.23/2025 datë 20 shkurt 2025

Procesmbajtësi
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit
Agim Maliqi